



UNIVERSITETI PUBLIK "KADRI ZEKA" UNIVERSITY

Zija Shemsu pn., 60000, Gjilan, Republika e Kosovës
www.uni-gjilan.net tel: 0280390112

Ref. nr. 01/2112 Dt. 28.09.2026

Senati i Universitetit Publik "Kadri Zeka" në Gjilan shpall:

KONKURS PLOTËSUES

për pranimin e studentëve në vitin e parë të studimeve postdiplomike - master për vitin akademik 2026/2027

Senati i Universitetit Publik "Kadri Zeka" në Gjilan, në bazë të kompetencave të përcaktuara sipas nenit 98 dhe 101 të Statutit, në mbledhjen e LXIII të mbajtur më 16.06.2026 ka miratuar propozimet e njësive akademike për numrin e studentëve që do të pranohen në vitin akademik 2026/27. Propozimet e numrit të studentëve pas miratimit nga Senati, janë aprovuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës (në tekstin e mëtejme MASHT).

I. KUSHTET E PËRGJITHSHME

Universiteti Publik "Kadri Zeka" në Gjilan, në vitin e parë të studimeve MASTER, për vitin akademik 2026/2027, do të regjistrojë **60** studentë të rregullt.

1. Nga numri i përgjithshëm i përcaktuar si në paragrafin 1, bazuar në UA nr. 09/2016 MASHT-it, Universiteti do të regjistrojë deri në **12%**, përkatësisht deri 15 studentë të rregullt nga komuniteti jo-shumicë. Kuota prej 12% të vendeve të rezervuara për regjistrim të studentëve nga komuniteti jo-shumicë do të shpërndahet në mënyrë proporcionale sipas përqindjes së numrit të përgjithshëm të studentëve për secilin departament apo program të fakulteteve veç e veç.
2. Në Universitet, në bazë të kuotave të përcaktuara nga MASHT dhe Senati, mund të pranohen edhe kandidatët nga Presheva, Bujanoci dhe Medvegja **2%**. Numri i studentëve të rregullt që do të pranohen si në paragrafin 1 të pikës I është deri **2** studentë. Kandidatët të cilët kanë lindur në vendet e sipërshtënuara, ndërsa shkollimin e mesëm e kanë kryer në ato vende.
3. Në Universitet, në bazë të kuotave të përcaktuara nga Senati, mund të pranohen edhe **2 %** e kandidatëve nga Shqipëria dhe Maqedonia, përkatësisht **3** studentë të rregullt, për secilin departament apo program të fakulteteve veç e veç.
4. Në Universitet, në bazë të kuotave të përcaktuara nga Senati, mund të pranohen edhe **1 %** e kandidatëve nga Mali i Zi, përkatësisht **0** studentë të rregullt, për secilin departament apo program të fakulteteve veç e veç.
5. Kandidatët nga Shqipëria, mbështetur në marrëveshjen e datës 20.06.2022 e lidhur ndërmjet dy ministrive respektive, mund të regjistrohen edhe në kuadër të numrit të përgjithshëm të studentëve me kushte të barabarta me ata kosovarë.
6. Të drejtë pranimi në Universitetin "Kadri Zeka" kanë të gjithë kandidatët kosovarë, të cilët e kanë përfunduar me sukses studimet themelore në Kosovë apo jashtë Kosovës dhe e kanë diplomën për shkollimin e kryer.



7. Kandidatët të cilët kanë përfunduar studimet paraprake në një program studimi, mund të konkurrojnë për regjistrim në studimet master në një program tjetër. Në rast pranimi, Këshilli i njësisë akademike, në propozim të Komisionit të Studimeve, mund të caktoj provime diferenciale të cilave duhet t'iu nënshtrohen paraprakisht kandidatët. Numri i provimeve caktohet varësisht nga shkalla e kalueshmërisë / ngjashmërisë së programit të ndjekur në studimet paraprake të kandidatit/es. Në raste të tilla, kandidatët ndjekin ligjëratat në vitin vijues akademik dhe iu nënshtrohen provimeve duke filluar në afatin e janarit, prillit, qershorit dhe shtatorit. Kandidatët do të kenë më së shumti deri 5 (pesë) provime diferenciale të cilave do t'iu nënshtrohen para komisionit prej tre anëtarësh ndërsa procesverbalet e provimeve të tilla ratifikohen nga Këshilli i njësisë përkatëse akademike.
8. Kandidatet të cilët kanë diploma jashtë Kosovës duhet ta bëjnë nostrifikimin e tyre në MASHT.
9. Universiteti do të sigurojë përgatitjen e testeve për provim pranues në gjuhën në të cilën kandidatët kanë përfunduar shkollimin paraprak dhe për të cilën deklarohen paraprakisht në formularin për vetë deklaram.
10. Deklarimi i rrejshëm në formularin për vetë deklaram, sipas nenit 391 të Kodit Penal (KODI NR. 04/L-082) të Republikës së Kosovës konsiderohet vepër penale.
11. Kandidatët të cilët kanë të regjistruar një program studimi në kuadër të Universitetit Publik "Kadri Zeka" nuk kanë të drejtë konkurrimi në program tjetër studimi pa përfunduar studimet në programin ku kanë qenë duke studiuar ose pa u çregjistruar nga programi aktual i studimeve.
12. Kandidatët për pranim si studentë në nivelin master në Universitetin Publik "Kadri Zeka" Gjilan, në vitin akademik 2025/2026 nuk mund të konkurrojnë më shumë se në një fakultet, departament, drejtim apo program.

II. MËNYRA E PËRZGJEDHJES SË KANDIDATËVE

1. Përzgjedhja e kandidatëve për të fakultetin do të bëhet sipas kriterëve si në vijim:

Numri maksimal i pikëve sipas kriterëve vijuese është 100 pikë

- **Suksesi në studimet themelore deri në 50 pikë;**
- **Suksesi në provimin pranues deri në 50 pikë.**

1. Të drejtë radhitjeje, përkatësisht pranimi kanë vetëm kandidatët që arrijnë së paku 40% nga numri i pikëve të parapara për provim pranues.
2. Kandidatët të cilët nuk arrijnë së paku **40%** nga numri i pikëve të parapara për provim pranues nuk mund të pranohen edhe nëse mbeten vende të paplotësuara sipas konkursit.
3. Nëse numri i pikëve të disa kandidatë të renditur si të fundit në listën e të pranuarve është i barabartë me kandidatë tjerë jashtë numrit të planifikuar për pranim, zgjedhja e kandidatëve do të bëhet në bazë të suksesit të provimit pranues, e nëse edhe pikët e provimit pranues janë të njëjtë atëherë përparësi do të kenë kandidatet e gjinisë femërore.
4. Regjistrimi i studentëve të pranuar në vitin e parë, bëhet në zyrën TI-së Hyrja B kati i I, sipas orarit të përcaktuar me këtë konkurs.



III. AFATET E KONKURSIT

Për regjistrimin e studentëve në vitin e parë të studimeve master oraret do të jenë si në vijim:

1. Aplikimi në platformën online **smu.uni-gjilan.net** hapet prej datës **29.09.2026** deri më datë **03.10.2026** në ora **15:30**.
2. Ditën e parë të konkursit, me datë **29.09.2026**, aplikimi online do të funksionalizohet nga ora **10:00**.
3. Dorëzimi i dokumentacionit fizik vetëm për kandidatët të cilët kanë aplikuar online do të bëhet prej datës **29.09.2026** deri më datë **03.10.2026**. Gjatë kësaj periudhe gjithashtu do të bëhet verifikimi i dokumentacionit nga personel i administratës së fakultetit përkatës.
4. Më **05.10.2026** do të publikohet në ueb-faqen e universitetit lista e kandidatëve dhe sallave ku do të mbahet provimi pranues.

Me rastin e paraqitjes, kandidatët duhet t'i sjellin këto dokumente:

- a) *Ekstraktin e lindjes (origjinal),*
- b) *Diplomën e fakultetit (origjinal apo të noterizuar), ose certifikatën e diplomës origjinale*
- c) *Kopjen e letërnjoftimit,*
- d) *Fletëparaqitjen e plotësuar e cila shkarkohet gjatë aplikimit online*
- e) *Vendimin mbi njohjen e shkollimit jashtë vendit. (vendimi bëhet në MASHT)*
- f) *Fletëparaqitja e plotësuar shkarkohet gjatë aplikimit online nga interneti:
Vegza (Linku) për konkurrim online përmes Internetit është: <http://smu.uni-gjilan.net>*

P.S. Pas nxjerrjes së dokumenteve dublikatë, dokumentet origjinale nuk mund të shfrytëzohen nga kandidati pasi që ky veprim konsiderohet vepër penale.

1. Njoftimet dhe oraret për vendin ku do të mbahen provimet pranuese mund të merren në shërbimin përkatës të Masterit, si dhe në ueb-faqen e universitetit.
2. Provimi pranues do të mbahet **më datë 06.10.2026**.
3. Të gjithë kandidatët në provim pranues duhet ta posedojnë letërnjoftimin, pa të cilën nuk mund t'i nënshtrohen provimit pranues.
Në kohën e mbajtjes së provimit pranues kandidatët nuk mund të kenë pranë vetes telefona celularë dhe asnjë mjet tjetër teknologjik.
4. Shpallja e rezultateve preliminare të provimit pranues do të bëhet, më së voni, deri më **06.10.2026** në ueb-faqen e universitetit.
5. Kandidatëve u rekomandohet që para paraqitjes në konkurs të bëjnë kopje të mjaftueshme të dokumenteve, sepse dokumentet origjinale nuk do të mund t'i tërheqin deri në diplomim apo çregjistrim nga fakulteti.
6. Për informata më të hollësishme, kandidatët mund t'u drejtohen shërbimit të studentëve të Masterit ose ta vizitojnë faqen e internetit: www.smu.uni-gjilan.net

IV. E DREJTA E ANKESËS DHE AFATI PËR ANKESË

1. Kandidatët të cilët sipas rezultatit preliminar renditen si kandidatë të pranuar, mund t'i paraqesin ankesë fakultetit përkatës **më së largu 24 orë pas publikimit të rezultateve preliminare** respektivisht për grupet si në vijim: **Ankesat bëhen më së voni deri më datë 07.10.2026, në ora 16:00;**
2. Pas afatit të përcaktuar si pikën e sipërshtënëuar ankesat nuk do të pranohen. Shqyrtimi i ankesave bëhet më **08.10.2026** në orën **10.00** nga Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave nga fakulteti përkatës .
3. Vetëm ankesat e bazuara mundë të procedohen në Komisionin Qendror të ankesave i cili komision merr vendim përfundimtar më datë 09.10.2025.
4. Kandidatët që nuk janë pranuar mund t'i tërheqin dokumentet e tyre në fakultetin përkatës nga data **09-15.10.2026** nga ora **9.00** deri në **16.00**.
5. Për informata më të hollësishme, kandidatët mund t'u drejtohen fakulteteve përkatëse ose ta vizitojnë faqen e internetit: www.uni-gjilan.net

V. SHPALLJA E REZULTATEVE PËRFUNDIMTARE

1. Shpallja e rezultateve përfundimtare të provimit pranues do të bëhet në tabelat e shpalljeve si dhe në ueb-faqen e universitetit, pas shqyrtimit të ankesave sipas grupeve të fakulteteve, bazuar në datat e mbajtjes së provimit pranues dhe atë: **më së voni deri më datë 09.10.2026, deri në orën 16:00;**

VI. REGJISTRIMI I KANDIDATËVE TË PRANUAR

1. Regjistrimi i kandidatëve të pranuar do të bëhet në bazë të orarit si në vijim:
 - Fakulteti i Edukimit
 - Mësimdhënie në Gjuhë dhe Letërsi Shqipe më **12.10.2026**
 - Mësimdhënie në Gjuhë Angleze më **12.10.2026**
 - Fakulteti i Shkencave Kompjuterike
 - Sistemet e Kontrollit dhe inteligjenca Artificiale më **13.10.2026**
 - E-Qeverisja më **13.10.2025**

Fotografimi/Regjistrimi bëhet në Zyrën e TI-së BS/13 nga ora 09:30-11:30 & 13:00-15:00 sipas orarit të lartshënuar. Studentët me vete duhet të kenë letërnjoftimin.

2. Në qoftë se kandidati i pranuar, në afatin e caktuar, nuk i përfill të gjitha procedurat e parapara në këtë konkurs, konsiderohet se ai/ajo ka hequr dorë nga e drejta e regjistrimit.
3. Jashtë këtij afati kandidatët e pranuar nuk do të mund të regjistrohen, prandaj luteni që t'i përmbaheni afatit të lartshënuar.



Tabela me numrat e paraparë për studentë të rinj për vitin akademik 2026-2027 sipas njësisë akademike dhe programeve

Fakulteti	Programi	Kuotat sipas konkursit					
		Nga Kosova	Presheva, Bujanoci dhe Medvegja 2%	komuniteti jo-shumicë 12%	Shqipëria & Maqedonia 2%	Mali i Zi 1%	Gjithsej
Edukimit (01)	Mësimdhënie në Gjuhë dhe Letërsi Shqipe (14)	9	0	2	0	0	11
	Mësimdhënie në Gjuhë Angleze (21)	22	1	5	1	0	29
Shkenca Kompjuterike (04)	Sistemet e Kontrollit dhe inteligjenca Artificiale (17)	1	0	4	1	0	6
	E-Qeverisja (18)	8	1	4	1	0	14
UKZ		40	2	15	3	0	60

FAKULTETI I EDUKIMIT

PROGRAMI : Mësimdhënie e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe

Provimi pranues:

- Gjuhë dhe Letërsi

Sqarim: Në këtë program mund të aplikojnë studentët të cilët i kanë përfunduar studimet në Gjuhë ose Letërsi Shqipe me 240 ECTS.

PROGRAMI : Mësimdhënie në Gjuhë Angleze

Provimi pranues:

- Gjuhë Angleze (English Language Proficiency Test)

Sqarim: Në këtë program mund të aplikojnë studentët të cilët i kanë përfunduar studimet në Gjuhë ose Letërsi Angleze me 240 ECTS.

FAKULTETI I SHKENCAVE KOMPJUTERIKE

PROGRAMI : Sistemet e Kontrollit dhe Inteligjenca Artificiale

Provimi pranues:

- Shkencat Kompjuterike/Mekatronikë/ Elektronike
- Matematikë

PROGRAMI: E-Qeverisje

Provimi pranues:

- Shkencat Kompjuterike (10 pyetje)
- Logjike (10 pyetje)
- Ekonomik (10 pyetje)
- Juridik (10 pyetje)

